Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Developement

TREGU I MISHIT

Shtator, 2015

DEPARTAMENTI I ANALIZAVE EKONOMIKE DHE STATISTIKAVE BUJQËSORE

TREGU I MISHIT TË GJEDHIT

Tetor, 2015

Parathënie

Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore është përgjegjës për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave ekonomike-statistikore të cilat e ndihmojnë MBPZHR-në që të hartojë raporte dhe analiza të detajuara mbi bazën e të cilave ndërmerren masat e duhura në hartimin e politikave bujqësore konform situatës aktuale.

Përmes këtij dokumenti është pasqyruar gjendja e prodhimtarisë së mishit, ku janë prezantuar të dhënat për prodhimtarinë vendore, eksportin, importin, çmimet e mishit në peshë të gjallë, çmimet e mishit në peshë të therur, si dhe janë vlerësuar nevojat e vendit për këtë produkt strategjik dhe shumë të rëndësishëm për vendin tonë.

Prodhimtaria e mishit në Kosovë ballafaqohet me shumë vështirësi, njëra ndër më kryesoret është numri i madh i fermave të madhësisë së vogël dhe zvogëlimi i numrit të fondit blegtoral. Si pasojë e kësaj situate kemi sasi të konsiderueshme të importit të mishit dhe produkteve të tij si nga vendet e regjionit e po ashtu edhe nga vendet e BE-së dhe vendet tjera.

Me qëllim të përmirësimit të situatës së tanishme dhe tejkalimit të vështirësive që e rëndojnë këtë prodhimtari, duhet të krijohen politika të favorshme për përforcimin e këtij nën sektori që kontribuon në përmirësimin e standardit të jetesës në zonat rurale, ndikon direkt në sigurinë e ushqimit dhe të ushqyerit, dhe njëherit ofron mundësinë e kthimit më të shpejt të të hyrave tek prodhuesit e vegjël.

Hyrje

Blegtoria është sektor shumë i rëndësishëm për vendin tonë, duke marrë për bazë mundësinë që ofrojnë kushtet natyrore për zhvillimin e këtij sektori si dhe gjendjen socio ekonomike të shoqërisë, sidomos shkalla e lartë e papunësisë në zonat rurale. Prodhimtaria e mishit tek ne është veprimtari sekondare dhe është aktivitet i fokusuar në majmërinë e viçave, që vjen nga fermat e orientuara kryesisht për prodhimin e qumështit. Fermat e specializuara me këtë lloj të prodhimit janë në numër shumë më të vogël.

1 Prodhimtaria vendore

Mishi i gjedhit është lloji i mishit që konsumohet shumë në Kosovë, krahas mishit të pulës qengjit dhe kategorive tjera blegtorale. Në këtë nën sektor dominojnë kryesisht fermat e vogla, ndërsa numri i fermave gjysmë komerciale dhe komerciale është mjaft i vogël.

Viteve të fundit në vendin tonë ka pasur ndryshime të konsiderueshme strukturore në fermat blegtorale. Fermerët me ferma të përziera blegtorale, duke parë tendencën e rritjes së çmimit të mishit të viçit kanë shfaqur interesin e tyre për tu orientuar në ferma të profilizuara për majmëri. Falë mbështetjes me subvencione dhe grante, numri i fermave të specializuara të gjedheve për majmëri dhe të lopëve qumështore është në rritje e sipër.

Tabela 1: Fondi dhe struktura e gjedheve, 2007-2013

Numri i kafshëve	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	Ndryshimi 2013/('10-'12) në %	Ndryshimi 2013/2012 në %
Fondi i gjedhëve	*321,624*	*341,608*	*344,078*	*356,727*	*361,878*	*329,213*	*321,385*	*-8*	*-2*
Viça deri në 6 muaj	68,176	75,476	74,167	80,834	83,524	73,336	*72,435*	*-9*	*-1*
Viça 6 muaj - 1 vit	43,090	50,206	45,348	50,277	50,837	43,926	*42,578*	*-12*	*-3*
Dema & mëshqerra 1-2 vjet	14,177	17,720	25,890	22,668	23,557	21,722	*18,944*	*-16*	*-13*
Dema & mëshqerra mbi 2 vjet	4,832	5,199	6,077	5,608	5,490	5,439	*7,210*	*31*	*33*
Lopë qumështore	189,706	191,529	190,216	194,984	196,155	183,340	*178,557*	*-7*	*-3*
Dema për riprodhim	1,368	1,066	2,125	2,125	2,125	1,450	*1,389*	*-27*	*-4*
Buallica	275	412	255	231	190	*159*	*272*	*41*	*71*

Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore

Bazuar në të dhënat e vitit 2013[1], numri i gjedheve është 321,385 krerë, prej tyre lopë qumështore 178,557; Viça 6 muaj - 1 vit 42,578 si dhe kategori të tjera, që janë të prezantuara në tabelën 1. Ndryshime në numër vërehen tek kategoria e buallicave që në krahasim me vitin 2012 kemi rritje për 71%. Rritje po ashtu kanë pasur kategoria e demave dhe mëshqerrave mbi 2 vjet (kategori këto që kryesisht shkojnë për riprodhim) me 33%. Numri i

[1] Të dhënat e fundit zyrtare nga AESHB të ASK-së janë të vitit 2013

gjedhëve është ulur për 2% në krahasim me vitin 2012, ndërsa krahasuar me mesataren e tri viteve 10'-12' rënia ishte 8%. Rënie të numrit për 13% hasim në kategorinë e demave dhe mëshqerrave 1-2 vjet, 4% në kategorinë e demave, 3% viça nga 6 muaj deri në 1 vit dhe 1% viçat deri në 6 muaj.

2 Tregu i mishit

Në fondin blegtoral ekzistues të gjedheve, 55.6% është pjesëmarrja e lopëve qumështore. Nga ky numër janë therur 156,062 krerë në vit. Vlerësohet se me këtë shkallë të prodhimit dhe me konsum mesatar për kokë banori prej 21.2 kg/vit, Kosova arrin të mbulojë 69.8% të kërkesave të tregut vendor për mish të gjedheve, ndërsa për përmbushjen e nevojave vendore vazhdon të importojë afro 30% të sasisë së mishit dhe produkteve të tij. Vlera e prodhimit të përgjithshëm nga kjo kategori blegtorale bazuar në kalkulimet e llogarive ekonomike sipas çmimeve të prodhimit ishte 68.2 mil. €[2].

Eksporti i produkteve të njëjta nga prodhuesit tanë është shumë i vogël dhe ka qenë i orientuar drejt vendeve të regjionit, kryesisht në Shqipëri. Dy vitet e fundit (2013 dhe 2014) nuk ka pasur fare eksport.

2.1 Importi i gjedheve në peshë të gjallë

Pasi që prodhimtaria vendore nuk mund të plotëson kërkesat vendore për mish gjedhi, Kosova importon një numër të madh edhe të gjedheve të gjalla, shumica prej të cilave përfundojnë në thertore. Kjo ndodh për shkak të deficitit të madh të mishit në vendin tonë.

Figura 1: Importi i gjedheve të gjalla 2005-2014



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

[2] Llogaria Ekonomike për Bujqësi 2013, ASK

Statistikat tregojnë se gjatë vitit 2007, kemi pasur import në peshë të gjallë prej 2 mil. kg ose 4,105 krerë nga kategoria e gjedheve apo shprehur në vlerë del se ka pasur import të kësaj kategorie prej 2.6 mil €. Njëherit ky ka qenë edhe viti me më pak import të gjedheve të gjalla. Nëse bëjmë krahasimin e importit të peshës së gjallë të vitit 2007 me vitin 2014, sasia e gjedheve të importuara është rritur për 302%. Kjo do të thotë se gjatë vitit 2014 janë importuar 16,500 krerë, apo mesatarisht 45 krerë brenda ditës.

Në vitin 2014 janë importuar 8.2 mil. kg peshë të gjallë ose 16,500 krerë gjedhe. Vendet prej nga Kosova ka importuar gjedhe ishin: Serbia (44%), Kroacia (24%), Bullgaria (10%), R. Çeke (9%), Rumania (5%), Gjermania (3%), Austria (2%), Hungaria (1%) dhe vende tjera me pjesëmarrje prej 2%.

Figura 2: Importi i gjedheve në peshë të gjallë nga disa shtete në vitin 2004



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Import më i madh i gjedheve me peshë të gjallë nga Serbia ka qenë në vitin 2009 (6.2 mil. kg peshë të gjallë ose 12,502 krerë gjedhe). Nëse krahasojmë importin nga Serbia të vitit 2014 me vitin 2011 vërehet ulje e sasisë ose numrit të krerve të importuar nga ky vend për 16%. Importi i gjedheve nga Serbia në krahasim me vendet tjera ka qenë dominues me një pjesëmarrje si në vijim: në vitin 2011 (72%), 2012 (57%), 2013 (23%) dhe në 2014 (45%).

2.2 Eksporti i kafshëve të gjalla sipas viteve

Sa i përket eksportit, bazuar në të dhënat nga Dogana e Kosovës, sasi më të madhe të eksportit ka pasur në vitin 2008 ku janë eksportuar 1,550 krerë gjedhe në peshë të gjallë. Po ashtu në vitin 2007 ka pasur eksport në sasi prej 460,215 kg peshë të gjallë, ose 1,260 krerë. Eksporti ka vazhduar edhe në vitin 2010, 2011 dhe 2012, ndërsa në vitin 2013 dhe 2014 nuk

ka pasur fare eksport. Vendet ku janë eksportuar gjedhet e gjalla janë kryesisht Shqipëria, Serbia, Mali i Zi dhe B. Hercegovina.

Figura 3: Eksporti i gjedheve të gjalla 2005-2014



Burimi: Llogaria ekonomike për bujqësi 2013, ASK

2.3 Therrjet e gjedheve sipas viteve

Sipas vlerësimeve të MBPZHR-së, rrjedh se për periudhën kohore 2005-2013 mesatarisht janë therrur 160,384 krerë gjedhe në vit. Numri më i madh i therrjeve është bërë në vitin 2011 (172,433 krerë gjedhe)[3], ndërsa më së paku në vitin 2009 (152,394 krerë).

Problem i pazgjidhur mbetet therrja jashtë therrtoreve, pa konfirmimin e veterinerit, sidomos në viset rurale ku edhe therrja bëhet vetëm për nevoja shtëpiake.

[3] Raporti i Gjelbër 2014

Figura 4: Therrja e gjedheve sipas viteve 2005-2013



Burimi: Vlerësim i MBPZHR-së

Sipas të dhënave të Anketës së Ekonomive Shtëpiake Bujqësore të vitit 2013[4], nga ekonomitë bujqësore është deklaruar se janë therrur 32,738 krerë gjedhe. Aktualisht në Kosovë janë gjithsej 45 therrtore për therrjen e kafshëve të trasha dhe 48 fabrika të aprovuara për përpunim të mishit[5]. Industria e përpunimit të mishit në Kosovë është rritur ndjeshëm në vitet e fundit, por ende karakterizohet nga një gamë e kufizuar e produkteve të ofruara dhe nga numri i vogël i ndërmarrjeve të mëdha. Këtë e vërteton edhe fakti se Kosova nuk ka eksport të këtyre produkteve siç janë lloje të ndryshme të sallamave, përgatitje të produkteve të homogjenizuara dhe produkte të tjera.

Nga të dhënat që posedojmë nga Dogana e Kosovës brenda vitit mesatarisht eksportohen 4.4 mil. kg lëkura të gjedheve ose shprehur në vlerë 7.8 mil. €. Sasia e eksportit të lëkurave të gjedheve nuk ka pasur shumë ndryshime sipas viteve dhe është sjellë rreth mesatares së paraqitur. Eksport më i madh ka qenë në vitin 2010 (5.4 mil. kg) ose 9.2 mil. €, ndërsa viti me më pak eksport ka qenë 2008 (3.3 mil. kg). Vlera më e lartë e eksportit të lëkurave të kësaj kategorie për vitet e prezantuara në figurën 5, ka qenë në vitin 2013 (11.3 mil. €) duke pësuar rënie për 9.6% në vitin në vijim.

[4] Publikimi i fundit nga ASK ka qenë në vitin 2013

[5] Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës

Figura 5: Eksporti i lëkurave të gjedheve 2005-2014



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Përveç sasisë së eksportuar të lëkurave të gjedheve gjithashtu ka pasur edhe import, por sasia ka qenë e vogël dhe është sjellë në një mesatare prej 110,551 kg ose shprehur në vlerë mesatare 75,823 €. Sasia më e madhe e importit ishte në vitin 2009 (305,776 kg) në vlerë prej 152,627 €. Sasi më e ulët e importit ka qenë në vitin 2010 (18,100kg) me vlerë 9,345 €.

Figura 6: Importi i lëkurave të gjedheve 2005-2014



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

2.4 Importi i mishit të gjedhit

Sasia e mishit të gjedhit të importuar gjatë viteve 2006-2014 ka pësuar luhatje të vazhdueshme, sasia më e madhe e importuar ishte në vitin 2008 me 10.5 mil. kg, ndërsa sasia më e vogël ishte në vitin 2012 me 4.8 mil. kg.

Figura 7: Importi i mishit të gjedhit sipas viteve 2006 - 2014



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Në periudhën 2009-2014, sasia e importuar e mishit të gjedhit vazhdimisht ka pësuar luhatje, mirëpo, gjatë vitit 2014 vërehet një rrije e konsiderueshme prej 44% në import krahasuar me vitin 2013.

Nga figura 8, shohim se sasia më e madhe e importit të mishit të gjedhit në Kosovë vjen nga Brazili, duke u përcjellur nga Polonia si vend i dytë prej nga është importuar mish më së shumti. Tri shtetet e tjera prej të cilave Kosova poashtu ka importuar janë Holanda, Paraguai dhe Argjentina.

Sasia e importuar e mishit të gjedhit nga Brazili gjatë viteve 2006-2014, ka shënuar luhatje të vazhdueshme. Viti me importin më të madh figuron të jetë viti 2006 me 6.8 mil. kg duke pasuar me vitin 2008 me 6.5 mil. kg. Gjatë periudhës 2011-2014 vërehet një ndryshim në sasinë e importuar, ku viti 2012 shënon vitin me më pak import nga Brazili me 2.2 mil. kg. Shteti tjetër dominues prej nga është importuar mishi i gjedheve ishte Polonia që në vitin 2014 shënon sasinë më të madhe të importit (3 mil. kg).

Figura 8: Vendet prej nga Kosova importon më së shumti mish të gjedhit sasia(kg)



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Kosova gjatë viteve 2006-2014 ka importuar mish të gjedhit edhe nga shtetet fqinje. Në vitin 2012 nga Mali i Zi ka importuar 22,325 kg ndërsa në vitin 2007 nga Serbia 17,404 kg. Për këtë të fundit, për periudhën kohore 2010-2012 nuk ka pasur fare import. Në vitin 2013 importi ishte 4,307 kg duke u rritur për 1,074% në 2014. Po ashtu edhe nga Maqedonia dhe Shqipëria është importuar por në sasi shumë të vogël.

2.4.1 Importi i mishit të gjedhit sipas muajve

Në figurën në vijim, është prezantuar importi i mishit të gjedhit sipas muajve. Në vitin 2014, sasi më të madhe të mishit të importuar vërehet se ka pasur gjatë tre muajve: Korrik, Qershor dhe Prill. Muaji Korrik, është karakterizuar si muaji me sasi më të madhe të mishit të importuar (1.07 mil. kg), pasuar nga muaji Qershor (1.01 mil. kg) dhe muaji Prill (0.99 mil. kg), kurse sasia më e vogël e importit ishte shënuar në muajin Shkurt me vetëm 0.49 mil. kg.

Figura 9: Importi i mishit sipas muajve të vitit 2014



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

2.5 Eksporti i mishit të gjedhit

Sasia e mishit të gjedhit të eksportuar nga prodhuesit Kosovar është shumë e vogël në krahasim me importin. Sasia e mishit të eksportuar ka qenë përgjithësisht e orientuar në katër vende të regjionit: B. Hercegovinë 9,960 kg në vitin 2006, duke shtuar eksportin në 22,989 kg në 2008 dhe zvogluar përsëri në 2010 në 691 kg. Në Maqedoni është eksportuar 1,500 kg në 2008, në Shqipëri 253 kg në 2012 dhe në Serbi 30,000 kg në vitin 2010.

Vlera më e lartë ka qenë në vitin 2008 (104,645 €) për sasinë e mishit të eksportuar (22,989 kg) të kategorizuar si mish i gjedhit "Çerekë të përparmë", eksportuar në Shqipëri dhe B. Hercegovinë, ku njëherit kjo është edhe sasia më e madhe e eksportuar ndonjëherë.

Figura 10: Eksporti i mishit të gjedhit 2006-2014



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Në figurën 10, është paraqitur eksporti i produkteve të mishit i kategorizuar si "mish i gjedheve, i freskët apo i ftohtë si dhe mish i ngrirë" për vitet 2006-2013. Gjatë viteve 2007, 2009, 2011, 2013, dhe 2014 nuk ka pasur fare eksport.

2.6 Bilanci tregtar për mishin e gjedhit

Vendi ynë ka bilanc tregtar negativ sa i përket mishit të gjedheve meqenëse karakterizohet me import të madh dhe eksport shumë të vogël. Vlera e importit të mishit të gjedheve në vitin 2014 ishte 21.4 mil. €, që në krahasim me vitin 2013 është rritur për 33%. Edhe sasia e mishit gjatë këtij viti gjithashtu ka shënuar rritje për 44% krahas vitit 2013. Sa i përket mishit të gjedhit në vitin 2014 nuk ka pasur eksport.

Figura 11: Bilanci tregtar i sasisë së mishit të gjedhit në Kosovë (kg)

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

3 Çmimet e tregut vendor

Çmimet e konsumit të mishit të gjedhit pa eshtra janë rritur gradualisht duke filluar nga viti 2006, kur ky çmim ishte 4.75 €, ndërsa në tri vitet e fundit mesatarisht ka arritur vlerën prej 6.06 €. Si çmim më i lartë për këto vite është shënuar ai i vitit 2013 (6.14 €), ndërsa në vitin 2014 ka pasur tendencë të rënies së çmimit krahas vitit paraprak për 3%.

Figura 12: Çmimet e konsumit për mish të gjedhit pa eshtra dhe mish viçi





Burimi: Sistemi Informativ i Tregut

Çmimet e konsumit të mishit të viçit, gjatë viteve 2006-2014 kanë shënuar vazhdimisht rritje. Çmimi më i ulët figuron të jetë në vitin 2006 në vlerë prej 5.30 €, kurse ai më i larti në vitin 2014 në vlerë prej 7.06 €.

Çmimi i konsumit të mishit të viçit është rritur për 5.4% në vitin 2014 krahasuar me çmimin e vitit paraprak.

Figura 13: Çmimet e mishit të lopës dhe të viçit në tregje të kafshëve





Burimi: Sistemi Informativ i Tregut

Çmimi i mishit të lopës (në peshë të gjallë), në tregjet e kafshëve nga viti 2006 e deri në vitin 2009 ka shënuar vazhdimisht rritje. Nga viti 2010 e deri me 2012 vërehet një trend i uljes së çmimit që vazhdoi deri në 2013 kur arriti vlerën 2.29 €, duke vazhduar me ngritje të çmimit në 2.52 € në vitin 2014 ose rritje prej 10%.

Nga figura 12, shihet se nga viti 2006 deri në vitin 2008 çmimi i mishit të viçit nëpër tregje të kafshëve ka pasur ngritje, ku në vitin 2008 arriti vlerën 2.52 €, dhe më pas pësoi ulje në vitin 2010 duke ulur vlerën në 2.25 €. Nga viti 2010 e deri më 2013, vërehet një trend i rritjes së çmimit ku shënohet edhe çmimi më i lartë për peshë të gjallë të viçit (2.75 €), përderisa në vitin në vijim kishte rënie të çmimit për 8%.

3.1 Çmimet e mishit të gjedhit të importuar për vitin 2014

Çmimet e mishit të gjedhit të importuar kanë qenë të ndryshme varësisht nga kategoria e caktuar e mishit. Në figurën 13, në vijim janë prezantuar çmimet e mishit të gjedhit të importuar në peshë të therrur gjatë vitit 2014. Këto çmime janë kalkuluar duke marrë pë bazë vlerën doganore për njësi të produktit të importuar.

Figura 14: Çmimet e mishit të gjedhit të importuar sipas kategorive, €/kg



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Çmimi më i lartë i mishit të importuar të gjedheve ka qenë për kategorinë mish me eshtra (4.10 €/kg). Pastaj kategoritë tjera të klasifikuara si mish i gjedhit i prerë apo i plotë në çerekë të gjymtyrëve të përparme (3.54 €/kg), si dhe kategori tjera të mishit të prezantuara në figurën 13.

4 Madhësia e tregut

Numri i përgjithshëm i gjedheve në vitin 2013 ishte 321,385 që në krahasim me vitin 2012 është shënuar rënie prej 2%. Sa i përket therrjes, 156,062 krerë janë therrur në vitin 2013 ose 2% më pak se në vitin 2012. Prodhimtaria e përgjithshme vendore në peshën e therrjes ishte 26.7 mil. kg të p.th. Konsumi gjatë vitit 2013 ishte 38.3 mil. kg p.th., kurse importi po ashtu në peshë të therrjes llogaritet të jetë 8,058 ton. Eksport të mishit ka pasur fare pak apo në vlerë simbolike kryesisht në vendet fqinje.

5 Produktet e mishit të gjedhit

Në grupin e produkteve të importuara të mishit bëjnë pjesë lloje të ndryshme të sallamave, suxhukut dhe përgatitje të tjera të homogjenizuara. Sipas të dhënave të Agjencisë së ushqimit

dhe Veterinës. Industria e përpunimit të mishit në Kosovë është rritur ndjeshëm në vitet e fundit, por ende karakterizohet nga një gamë e kufizuar e produkteve të ofruara dhe nga numri i vogël i ndërmarrjeve të mëdha. Këtë e vërteton fakti se Kosova ka shumë pak eksport të këtyre produkteve.

Figura 15: Importi i produkteve të mishit të gjedhit sipas viteve 2005-2014

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Sipas viteve të prezantuara duke filluar nga viti 2006 sasia e importit të produkteve të mishit është rritur gradualisht deri në vitin 2009 duke vazhuar me luhatje deri në vitin 2014 kur edhe është shënuar sasia më e lartë prej 5.7 mil. kg). Krahasuar me vitin 2013, sasia e importit të produkteve të mishit të gjedhit në vitin 2014 është rritur për 34%.

Figura 16: Eksporti i produkteve të mishit



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Eksport të produkteve të mishit nga Kosova ka pasur në sasi shumë të vogël në vitin 2006, 2009, 2010. Në vitin 2013 sasia është rritur nga 2,235 kg, që ishte në vitin 2012 në 17,217 kg ose shprehur në vlerë 26,782 €. Ngritje më të madhe të sasisë së eksportit të produkteve të mishit të gjedhit ka pasur në vitin 2014 (202,317 kg) ose shprehur në vlerë monetare 273,888 €. Eksporti i produkteve të mishit të gjedhit në vitin 2014 krahasuar me vitin 2013 është rritur për 1,075%.

6 Ndikimi i prodhimtarisë së mishit në punësim dhe mundësia e krijimit të vendeve të reja të punës

Meqenëse në Kosovë fermat e specializuara për gjedhe për majmëri ende nuk janë mirë të profilizuara, sipas vlerësimeve të bëra për angazhimin e fuqisë punëtore të angazhuar në fermat e përziera (lopë qumështore dhe gjedhe për majmëri), një punëtor me orar të plotë të punës mund të kujdeset apo të angazhohet mesatarisht për 10 krerë gjedhe gjatë një viti.

Nga Njësia Vjetore e Punës së hargjuar në këtë sektor rezulton se 13,873 punëtor janë të angazhuar në ferma të specializuara (mish, qumësht) dhe 14,312 punëtorë në ferma të përziera. Angazhimi i numrit të punëtorëve varet kryesisht nga investimet në përmirësimin e infrastrukturës në fermë, ku sa më tepër të përdoret teknologjia e avancuar aq më tepër rritet numri i krerëve të lopëve për të cilën mund të kujdeset një punëtor me orar të plotë të punës.

7 Mbështetja e prodhimtarisë së mishit të gjedhit

7.1 Grantet Investive të Zhvillimit Rural 2013-2015

Në shumicën e fermave prodhimtaria e mishit tek ne është veprimtari sekondare dhe është aktivitet i fokusuar kryesisht në majmërinë e viçave, që vjen nga fermat që janë të orientuara kryesisht për prodhimin e qumështit. Edhe pse ka përpjekje nga fermerët për profilizimin e kësaj kategorie, fermat e specializuara të gjedheve për majmëri në vendin tonë janë në numër shumë të vogël. Me qëllim të përkrahjes së këtij nën sektori të blegtorisë janë ndarë grante investive në kuadër të Masësa 101 (2), ku është përkrahur prodhimi i mishit të viçit ose kategoria e fermave të viçave për majmëri. Po ashtu për vitin 2015 është planifikuar buxheti për subvencionimin e therjeve të raportuara të gjedhit në vlerë prej 750,000 €.

Tabela 2: Grantet investive të Zhvillimit Rural 2013 -2015

	2013		2014		2015	
Masa 101 (2)	Vlera totale e mjeteve/€	Niveli i mbështetjes(%)	Vlera totale e mjeteve/€	Niveli i mbështetjes(%)	Vlera totale e mjeteve/€	Niveli i mbështetjes(%)
	350,000	65	500,000	60-75	1,000,000	60-75

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë

Figura 17: Grantet investive të Zhvillimit Rural 2013 /2014 /2015



Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë

Vlera totale e mjeteve për Masën 101(2) për mbështetjen e kësaj kategorie të gjedheve ka filluar për herë të parë në vitin 2013. Nga ky vit vlera fillestare e këtij granti investiv ka qenë 350,000 €, ndërsa niveli i mbështetjes ka qenë 65%. Në vitin 2014, kjo masë e mbështetjes që përfshinë viçat për majmëri ka arritur vlerën prej 500,000 €, ose 43% më e lartë krahasuar me vitin 2013 dhe me rritje të nivelit të mbështetjes nga 60 në 75%. Në vitin 2015 vlera totale ka arritur në 1,000,000 € ose 50% më tepër se sa në vitin 2014 dhe niveli i mbështetjes për këtë vit është 60-75%.

8 Prodhimtaria mishit të gjedhit në tregun botëror

Shtetet e Bashkuara janë prodhuesi më i madh i mishit të gjedhit në botë pasuar nga Brazili dhe Bashkimi Evropian. SHBA (19.08%), Brazil (16.85%) dhe Bashkimi Evropian (12.88%) prodhojnë pothuajse gjysmën e mishit të viçit në botë. Ndër prodhuesit tjerë të mëdhenjë janë Kina e cila prodhon 10%, India 6.80% si dhe vende tjera që kontribuojnë me 34.39% .

Tabela 3: Prodhimtaria e mishit të gjedhit në botë

Radhitja	Vendi	2014	Pjesmarrja(%)
1.	SHBA	11,230,000	19.08%
2.	Brazili	9,920,000	16.85%
3.	Vendet e BE-së	7,580,000	12.88%
4.	Kina	5,760,000	9.79%
5.	India	4,000,000	6.80%
6	Argjentina	2,900,000	4.93%
7	Australia	2,240,000	3.81%
8	Meksika	1,820,000	3.09%
9	Pakistani	1,675,000	2.85%
10	Rusia	1,380,000	2.34%
11	Shqipëria	36,000	0.06%
12	B. Hercegovina	22,000	0.04%
13	Maqedonia	5,000	0.01%
14.	Te tjera	10,288,000	17.40%
15.	**Gjithsej**	**58,856,000**	**100%**

Burimi: World Beef Production; http://beef2live.com/main.aspx;

Figura 18: Prodhimtaria e mishit të gjedhit në botë



Burimi: World Beef Production

India ka inventar më të madh të gjedheve në botë pasuar nga Brazili dhe Kina. Rreth 61% e bagëtisë në botë janë në Indi, Brazil dhe Kinë. India ka pasur rritjen më të madhe në prodhimin e mishit të gjedheve në vitin 2013 pasuar nga Brazili dhe Argjentina. Konsumuesi më i madh i mishit të gjedhit në botë është SHBA-ja, pasuar nga Brazili, vendet e Bashkimit Evropian si dhe vendet tjera. Konsumuesi më i lartë i mishit të gjedhit për kokë banori në botë është Hong Kongu, pasuar nga Argjentina dhe Uruguai.

Konkluzione dhe rekomandime

Për të mundësuar zhvillim më të qëndrueshëm të sektorit, industria e mishit duhet të zgjeroj kapacitetet përpunuese, të bëjë modernizimin e linjave teknologjike dhe zbatojnë standardet e sigurisë ushqimore.

Prodhimtaria vendore e industrisë së përpunimit të mishit të orientohet kryesisht në drejtim të krijimit të produkteve të reja (diversifikimin e produkteve) të cilat vazhdimisht importohen dhe për të cilat kërkesat janë në rritje në tregun e Kosovës, si dhe të përcjell preferencat e konsumatorëve.

Senzibilizim më i madh i fermerëve rreth mundësisë së shfrytëzimit të pagesave direkte për subvencionimin e fermave të gjedheve për majmëri.

Nëse dëshirojmë që të zvogëlojmë importin dhe shkallën e lartë të papunësisë, pengojmë migrimin, ulim shkallën e varfërisë në zonat rurale, është shumë e rëndësishme të vazhdohet përkrahja e fuqishme e këtij sektori me subvencione dhe forma tjera të përkrahjes.

Kjo formë e përkrahjes do ti stimuloj fermerët që të merren me këtë veprimtari mjaft fitimprurëse në mënyrë që të shtohet numri i krerëve të lopëve të racave fisnike.

Ndikimi i këtyre investimeve është i prekshëm dhe i matshëm, dhe si rezultat do të kemi uljen e importit dhe shtimin e eksportit.